



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 43

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 29 tetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1044, datë 26.10.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit..... 3



NJOFTIM

Nr. 1044, datë 26.10.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 2, germa “c”, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë Maqellarë, të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, Mat	Maqellarë, Dibër	43 744 160	43 591 140	153 020	1 093	1 093	18.9.2018	10:00	DDPP

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për

objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit, subjektit të shpronësuar Sabri Kadriu (Nasufi).

Afati i publikimit fillon në datën 29.10.2018 dhe mbaron në datën 28.11.2018.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018